

ETLEVA SMAÇI

Akademia e Forcave të Armatosura

etleva.smaci@aaf.mil.al; evasmaci@gmail.com

**DIPLOMACIA USHTARAKE¹ KINEZE NË KUADËR TË
MARRËDHËNIEVE SHQIPËRI-KINË: NJË TRAJTESË NGA
ARKIVAT SHQIPTARË
(1963-1975)**

Abstrakt:

Ky punim synon të analizojë raportet diplomatike në fushën ushtarake mes Shqipërisë dhe Kinës nga viti 1963 deri në vitin 1975. Periudha kohore e zgjedhur për analizë përkon me momentin e intensifikimit të marrëdhënieve ushtarake e shkon deri në bjerrjen e tyre, pa ndonjë fërkim dhe demonstrim force siç ndodhi me Bashkimin Sovjetik.

Teza qendrore e këtij punimi është se marrëdhëniet ushtarake Shqipëri-Kinë ishin marrëdhënie të pastra interesi ekonomik dhe ideologjik, pa pika takimi në parime dhe doktrina ushtarake. Si të tilla, ato kushtëzuan tjetërsimet doktrinore dhe qasjen për rolin e ushtrisë shqiptare në fushën e mbrojtjes. Në mbështetje të kësaj teze, analizohen arsyet politike që përcaktuan një diplomaci ushtarake soft dhe smart nga pala kineze, duke shkurajuar çdo përpjekje shqiptare për një aleancë mirëfilli ushtarake apo iniciativa në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë që binte ndesh me politikën e jashtme të Kinës.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është një shqyrtim i literaturës historike të autorëve të huaj dhe vendës, që kanë analizuar disa nga aspektet më të rëndësishme politike dhe ekonomike të marrëdhënieve shqiptaro-kineze. Fokusi në çështjet ushtarake dhe shfrytëzimi i burimeve arkivore të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura të Shqipërisë është një risi, në raport me punimet e mëparshme që trajtojnë aleancën shqiptaro-kineze.

¹ Në këtë punim termi “diplomaci ushtarake” do t’i referohet në një sens më të gjerë një tërësie aktiviteteesh jo të dhunshme në politikën e jashtme dhe / ose programeve të një shteti, për të përmbushur interesat e politikës së tij të brendshme dhe sigurinë e tij të jashtme në raport me një ose disa vende të tjera.

Ballafaqimi i këtyre dokumenteve me literaturën e përdorur gjykojmë se do të japë një panoramë më të plotë se në ç'raport qëndronin lidhjet ushtarake të Kinës me Shqipërinë në politikën e jashtme të të dyja vendeve, veçanërisht Kinës. Përfundimet bazohen kryesisht në dokumentacionin shqiptar. Analiza e marrëdhënieve ushtarake përfshin raportet e të dyja vendeve duke cekur raportet e secilit prej tyre me Traktatin e Varshavës (TV), organizatë ushtarake dhe politike e vendeve komuniste, kundërshtare e NATO-s. Për ta përmbyllur, simbioza ushtarake - politike e Kinës dhe e Shqipërisë në përballje me Bashkimin Sovjetik, është një pazëll interesant idesh dhe mesazesh që vlejnë të deshifrohen në kuadër të studimit të historisë së Luftës së Ftohtë brenda vetë Kampit Komunist.

Fjalë kyçe:

Ndihmë ushtarake, traktat mbrojtjeje, doktrinë, Kinë-Shqipëri, armatim, Luftë e Ftohtë, Traktati i Varshavës.

Hyrje

Marrëdhëniet shqiptaro-kineze gjatë Luftës së Ftohtë janë objekt i gjerë studimi nga studiues të huaj dhe shqiptarë. Që prej fillësës së tyre në punimet e hershme të William Griffith-it² dhe Harry Hamm-it,³ në analizën e marrëdhënieve shqiptaro-kineze vëmendja më e madhe është përqendruar në shpjegimin teorik se çfarë roli duhej t'i njihej Shqipërisë së vogël në tablonë e konfliktit madhor në botën komuniste mes BS-së dhe Kinës në vitet '60. Kjo tezë është trajtuar edhe nga Lorenz Lüthi, i cili e pa rolin e Shqipërisë në konfliktin sovjetiko-kinez edhe në kuadër të aleancës ushtarake të Bllokut Komunist, Traktatit të Varshavës, gjithmonë si një sfidë për të dobësuar rolin e Moskës, por pa analizuar në detaje funksionet e diplomacisë ushtarake.⁴ Një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e panoramës së përgjithshme se çfarë motivoi një aleancë aspak të barabartë mes Shqipërisë dhe Kinës ka dhënë studiuesi Elez

² William E. Griffith, *Albania and the Sino-Soviet Rift* (Cambridge: M.I.T. Press, 1963).

³ Harry Hamm, *China's beachhead in Europe* (New York: Frederick A. Praeger, 1962).

⁴ Lorenz Lüthi, "The People's Republic of China and the Warsaw Pact Organization, 1955-1963", *Cold War History* 7, no. 4 (2007): 479-494; shih gjithashtu: Lorenz Lüthi, *The Sino-Soviet Split. Cold War in the Communist World* (Princeton and Oxford: Princeton University Press, 2008).

Biberaj,⁵ me një punim të plotë në fund të viteve '80, ku i mëshon idesë se kjo aleancë më së shumti ishte politike sesa ushtarake. Duke iu referuar Biberajt, gjatë shqyrtimit të literaturës për këtë punim është vërejtur, se ai është ndër të paktët autorë që cek disa çështje doktrinale ushtarake (të cilat do të jenë pjesë e rëndësishme e këtij artikulli) në analizat e tij në lidhje me marrëdhëniet Shqipëri-Kinë pas viteve '90 referuar arkivave shqiptarë.⁶ Po kështu, referuar këtyre arkivave disa studiues të rinj të Luftës së Ftohtë kanë shtjelluar gjerësisht marrëdhëniet shqiptaro-kineze në aspektin politik, ekonomik dhe kulturor. Studiuesi Elidor Mëhilli,⁷ ashtu siç e thekson Ylber Marku, e ka parë këtë raport veçanërisht me qasjen se si ajo formësoi shoqërinë socialiste shqiptare. Por, ajo që përbën një interes të zgjeruar për këtë punim është analiza që Mëhilli i bën qasjes gjeopolitike dhe ndihmave kineze duke hedhur dritë mbi faktet se si shtetet e vogla janë të afta të manovrojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁸ Kjo është një qasje që mbështet idenë e këtij punimi se diplomacia ushtarake kineze që ruajti të njëjtat parime me politikën e saj të jashtme, i dha mundësi një shteti të vogël si Shqipëria të shfrytëzonte pozicionin e saj ideologjik në këmbim të përfitimeve ushtarake dhe jo vetëm.

Rivlerësimin e rolit të një vendi të vogël si Shqipëria gjatë Luftës së Ftohtë në kuadër të një konteksti ndërkombëtar, në kërkim të një agjende politike personale në marrëdhëniet Shqipëri-Kinë e gjejmë edhe te studiuesi Ylber Marku⁹ (përmendur më lart). Ai ka një sërë punimesh, ku

⁵ Elez Biberaj, *Albania and China. A Study of an Unequal Alliance* (Boulder and London: Westview Press, 1986).

⁶ Elez Biberaj, "Albanian-Chinese Relations 1962-1969", *Tirana Observatory: Foreign Policy and International Relations* 2, no. 3 (2020), 280-281 (shikuar më 21.06.2023). <https://tiranaobservatory.com/2020/07/06/albanian-chinese-relations-1962-1969/>

⁷ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World* (Ithaca and London: Cornell University Press, 2017), cituar në Ylber Marku, "Communist relations in crisis: The end of Soviet-Albanian relations, and the Sino-Soviet split, 1960-1961", *The International History Review* 42, no. 4 (2020): 813-832.

⁸ Elidor Mëhilli, "A Window into Mao's China, 1950-1970", në *A blog of the History and Public Policy Program* (Wilson Center, on December, 12, 2022) (shikuar më 20.06.2023).

<https://www.wilsoncenter.org/blog-post/window-maos-china-1959-1970>

⁹ Ylber Marku, *Sino-Albanian relations during the Cold War, 1949-1978: an Albanian perspective*, Tezë Doktorature (Hong Kong: Lingnan University, 2017; shih gjithashtu Ylber Marku, "Communist relations in crisis: The end of Soviet-Albanian relations,

shqyrton dinamikat ideologjike brenda trekëndëshit Moskë-Tiranë-Pekin. Së fundmi, çështjet ushtarake mbi të cilat do të fokusohet ky punim në aspektin e ndihmave ekonomike janë pjesë e shqyrtimit të disa artikujve të studiuesit Gjon Boriçi,¹⁰ por, ashtu siç përcaktohet edhe në titujt e këtyre artikujve, ato janë më së shumti pjesë e një analize të rëndësishme të marrëdhënieve ekonomike Shqipëri-Kinë.

Objekt i këtij punimi është tentativa për të analizuar përpjekjet e qeverisë shqiptare për të ndërtuar krahas aleancës ideologjike edhe një aleancë ushtarake me aleatën e re Kinën, në mesin e viteve '60. Nga shqyrtimi i literaturës së cituar, konstatohet se aspekti ushtarak nuk është parë si një komponent i veçantë në punimet e autorëve të përmendur. Ai nuk është trajtuar në aspektin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, por si pjesë e konfliktit ideologjik kinezo-sovjetik dhe sovjetiko-shqiptar. Bazuar në dokumentacionin e arkivave shqiptarë, punimi synon të plotësojë panoramën mbi angazhimin ushtarak të Kinës te një aleat i vogël dhe i largët si Shqipëria. Shqyrtimi i dokumenteve nga arkivat shqiptarë tregon se Kina, ndryshe nga Bashkimi Sovjetik, u tregua shumë e matur kur bëhej fjalë për çështjet ushtarake që cenonin elementet e sigurisë së saj në raport me Kampin Socialist, si dhe në rang botëror. Prandaj, ashtu si edhe me të drejtë pohon studiuesi Hamit Kaba, në vazhden e traditës së ankorimit pas një vendi tjetër, rasti i Republikës Popullore të Kinës do ta ndihmonte Shqipërinë më tepër në plotësimin e nevojave ekonomike sesa atyre ushtarake.¹¹ Veçanërisht në fushën e diplomacisë ushtarake një mjet domethënës në politikën globale për sa u përket aleancave, marrëdhënia ushtarake mes Shqipërisë dhe Kinës në

and the Sino-Soviet split, 1960-1961", *The International History Review* 42, no. 4 (2020), 813-832 (shikuar më 20.06.2023). DOI:10.1080/07075332.2019.1620825

¹⁰ Gjon Boriçi, "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë 1974-1975", në *Studime historike*, nr. 1-2 (2018): 255-272; shih gjithashtu: Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1987*, bot. II, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2022); po ai, *Shqipëria dhe Kina, marrëdhënie e ngushtë në sfondin e Luftës së Ftohtë. Dokumente 1956-1978*, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2020).

¹¹ Hamit Kaba, *Shqipëria dhe të Mëdhenjtë nga Lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë* (Tiranë: Klean, 2015), 228; shih gjithashtu: Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1987*, bot. II, ASA, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2022); shih gjithashtu: Elez Biberaj, *Shqipëria dhe Kina, një aleancë e pabarabartë* (Tiranë: AIIS, 2014); shih gjithashtu: Enver Bytyçi, *Shqipëri-Kinë, dështimi i një bashkëjetese* (Tiranë: Instituti i Studimeve të Europës Juglindore, 2014).

mesin e viteve '60 mendojmë se paraqet interes studimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik do të linte në amulli, por edhe në boshllëk si shumë fusha të tjera edhe investimet në fushën e mbrojtjes, të cilat kishin qenë prioritet i Moskës në Shqipëri.¹² Mangësitë e krijuara në fushën e armatimit, qeveria shqiptare tentoi t'i kapërcente përmes forcimit të marrëdhënieve ushtarake me Kinën dhe nismave të përbashkëta në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, sidomos duke filluar nga viti 1963.¹³

Kina dhe Shqipëria, në një front kundër nismës SHBA-BS për çarmatim bërthamor¹⁴

Viti 1963 u shoqërua me disa zhvillime të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat patën ndikim edhe në Shqipëri. Më 20 shkurt 1963, delegacioni i Bashkimit Sovjetik paraqiti në komitetin e 18 shteteve për çarmatimin një projekt-pakt mossulmimi midis vendeve të Traktatit të Varshavës dhe NATO-s. Ky ishte një projekt i hershëm që nga koha kur Shqipëria merrte pjesë aktive në mbledhjet e traktatit dhe kishte kulmuar si iniciativë në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të 24 majit 1958.¹⁵ E gjendur tashmë *de facto* jashtë Traktatit të Varshavës, qeveria shqiptare u njoh me përmbajtjen e notës që Bashkimi

¹² Biberaj, "Albanian-Chinese Relations 1962-1969", 274-289.

¹³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (AP)-Organet Udhëheqëse (OU), Viti (më tej: V.) 1968, Dosja (më tej: D.) 12, fl. 40. Mbi dërgimin e anëtarit të Bashkimeve Profesionale dhe ministër i Mbrojtjes shokut Beqir Balluku në RPK. "Teza mbi disa çështje për të biseduar me shokët e udhëheqjes së PKK-së.

¹⁴ Douglas Selvage, "The Warsaw Pact and Nuclear Nonproliferation, 1963-1965", në *Cold War International History Project* Vol. 32 (Woodrow Wilson International Center of Scholars, 2001). Gjatë vitit 1963-1964, viti i fundit i Nikita Hrushovit në drejtimin e PKBS-së, ai shfaqti vullnet për të pranuar armatosjen e Republikës Federale Gjermane me armë bërthamore nga NATO, në shkëmbim të nënshkrimit të një marrëveshjeje për ndalimin e testeve bërthamore. Qëllimi kryesor i kësaj nisme shihej si një mjet presioni ndaj Republikës Popullore të Kinës për të ndaluar programin e saj bërthamor në zhvillim e sipër.

¹⁵ *AQSH*, F.14 /AP-MP PK/(b) BS, V. 1958, D. 2, fl. 25; shih gjithashtu: Etleva Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës* (i pabotuar, disertacion për gradën "Doktor i shkencave", Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2017).

Sovjetik i drejtonte SHBA-së për kthimin e zonës së Mesdheut në një zonë pa armë bërthamore, më 23 maj 1963.¹⁶

Qeveria shqiptare iu përgjigj zyrtarisht njohjes me këtë notë më datë 10 qershor. Qëndrimi i mbajtur ravizonte kundërshtimin e hapur ndaj nënshkrimit të një pakti mossulmimi mes vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës dhe NATO-s. Argumenti kryesor i palës shqiptare ishte se nga ky pakt mund të siguroheshin nga sulmet vendet socialiste të Traktatit të Varshavës, por jo Shqipëria.¹⁷ Madje, ajo konstatonte se qeveria sovjetike me Hrushovin dhe qeveritë e tjera të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, jo vetëm nuk i zbatonin angazhimet në lidhje me Shqipërinë, por i kishin shkelur dhe i kishin bërë pa asnjë fuqi vepruese.¹⁸

Rikthimi i propozimit ngjalli dyshime tek udhëheqja shqiptare. Këto dyshime ishin të nxitura edhe nga angazhimi që ishte marrë me Kinën, për të dënuar dhe për të denoncuar nisma të tilla.¹⁹ Në datën 5 gusht që përkonte me nënshkrimin e Traktatit të Moskës,* Kryetari i Këshillit të Ministrave, Mehmet Shehu pati një takim me ambasadorin kinez në Shqipëri, Lo Shi Gao. Fokusi i takimit ishte mbi përmbajtjen e deklaratës që qeveria shqiptare do të lëshonte me rastin e nënshkrimit të traktatit për ndalimin e pjesshëm të provave bërthamore midis SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik. Takimi vinte pas deklaratës që Kina kishte bërë më 31 korrik, të cilën qeveria shqiptare jo vetëm e kishte pritur me entuziazëm, por edhe e kishte përkrahur hapur. Për Mehmet Shehun traktati nuk ishte gjë tjetër veçse një hap i Hrushovit për të krijuar një front unik kundër Kinës që shihej si pengesë kryesore.²⁰

¹⁶ AMPJ, V. 1963, D. 101, fl. 2. Relacion skematik mbi marrëdhëniet e vendit tonë me BS-në gjatë vitit 1963, përgatitur nga Lllazar Muço.

¹⁷ Po aty, V. 1964, D. 588, fl. 7. Material lidhur me Traktatin e Varshavës.

¹⁸ Po aty, fl. 3.

¹⁹ AQSH, F 14/AP- Marrëdhëniet me Partitë e tjera Komuniste (më tej: MP), V. 1963, D. 5, fl 1-15; shih gjithashtu: Biberaj, "Albanian-Chinese Relations 1962-1969", 277; shih gjithashtu: Bytyçi, *Shqipëri-Kinë*, 250.

* Traktati i Moskës u firmos më 5 gusht 1963 mes Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-së dhe ndalonte testimet e armëve bërthamore ose çdo eksplozion nuklear në atmosferë, hapësirë kozmike apo nën ujë. Ai u ratifikua nga SHBA-ja në Senat më 24 shtator 1963 dhe hyri në fuqi më 10 tetor të po atij viti.

²⁰ Po aty, fl. 3.

Kina ishte vetëm një hap larg testimit të bombës atomike dhe po tentonte të bëhej anëtarja e pestë legale e klubit atomik.*

Mehmet Shehu parashtrroi në takim nevojën, që, përpara se qeveria shqiptare të dilte me një deklaratë të sajën të këshillohej me qeverinë e Republikës Popullore të Kinës, si dhe të merrte mendimin e saj mbi propozimin e palës shqiptare për thirrjen e një mbledhjeje të kryetarëve të qeverive të Kampit Socialist pas denoncimit faktik të këtij traktati. Përgjigjja kërkohet e shpejtë, për të mos vonuar deklaratën (2-3 ditë).²¹ Gjithashtu, Mehmet Shehu parashtrroi edhe arsyet e refuzimit të nënshkrimit të traktatit në këtë moment nga qeveria shqiptare, e cila gjykonte se ky traktat do t'i hapte rrugën aleancës SHBA-BS dhe do të krijonte premisat që forcat kryesore të NATO-s të ishin të lira të vepronin kundër Kinës me potencialin e forcave të tyre ushtarake në kuadër të SEATO-s, pasi nuk do të kishin asnjë shqetësim në sektorin e Europës. Në qasjen tepër të njëanshme të Tiranës kuptimi i gjithë kësaj lëvizjeje përkthehej: paqe në Europë, luftë në Azi, pra kundër Republikës Popullore të Kinës. Sigurisht, argumenti tjetër ishte se ky pakt bëhej në “shpinë” të Shqipërisë që ishte ende anëtare e Traktatit të Varshavës.²²

Nisur nga këto rrethana, Tirana zyrtare i propozonte Pekinit që ajo të ndërmerre nismën e denoncimit të traktatit qoftë për shkelje të procedurave nga ana e qeverisë sovjetike, qoftë për veprimin në kundërshtim me angazhimet që buronin nga Traktati i Varshavës.** Gjithashtu, Shehu kërkoi mendimin e qeverisë kineze që çështjet e ngritura nga ata në deklaratën e 31 korrikut të propozoheshin që të përfshiheshin në sesionin e ardhshëm të OKB-së dhe këtë kërkesë do ta bënte RPSH-ja. Nëse ajo do të arrinte të futej në rendin e ditës, shihej si një sukses i madh. Por, në fakt, Mehmet Shehu ishte i ndërgjegjshëm se Shqipëria do të ishte një zë i vetëm në këtë çështje.²³

* Deri në vitin 1963 zotërues të bombës atomike ishin SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Franca.

²¹ *AQSH*, F 14/AP-MP, V. 1963, D. 5, fl. 4.

²² *Po aty*, fl. 5.

** Qeveria shqiptare i referohej në këtë rast nenit 3 të dokumentit zyrtar të Traktatit të Varshavës që përcaktonte qartë konsultimin mes anëtarëve të Traktatit mbi çështje të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat kishin lidhje me interesat e përbashkët, duke pasur si parim udhëheqës forcimin e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar.

²³ *AQSH*, F. 14/AP-MP, V. 1963, D. 5, fl. 8-9.

Përgjigjja kineze për pyetjet e ngritura nga pala shqiptare nuk vonoi. Më datën 12 gusht, ambasadori kinez u ritakua me Mehmet Shehun. Qeveria kineze dakordësoi që qeveria shqiptare të dilte me një deklaratë në lidhje me marrëveshjen dhe ajo do të mbështetej në mënyrë aktive nga Kina. Por ajo që qeveria kineze kërkonte nga pala shqiptare ishte marrja në konsideratë e disa ndryshimeve në tekstin e deklaratës, që vinin theksin tek teza se marrëveshja çonte në krijimin e monopolit të armëve bërthamore veçanërisht nga SHBA-ja dhe rriste strategjinë e shantazhit.²⁴ Për sa i përket idesë se Europa lihej e lirë nga ky traktat, Kina mendonte se ky propozim nuk i sillte Europës paqe (konstatim i drejtë) dhe propozonte dy hapa: *së pari*, dënimin e veprimeve të Bashkimit Sovjetik në raport me Shqipërinë si anëtare e traktatit, duke mos e bërë pjesë të konsultimeve për këtë marrëveshjeje; *së dyti*, çështja e dënimin (denoncimit) të marrëveshjes trajtohej si një çështje ku duhej të tregohej maturi. Ajo e këshilloi qeverinë shqiptare se duhej të shihej situata që do të krijohej pas nënshkrimit të traktatit dhe më pas të shqyrtohej çështja e dënimin të tij.²⁵

Po kështu, Pekini e uli vullin e propozimit shqiptar për mbledhjen e krerëve të Kampit Socialist pas denoncimit faktik të traktatit. Ajo i rikujtoi qeverisë shqiptare se kjo mbledhje me shumë gjasa do të thirrej në Moskë, çka do t'i vinte para faktit udhëheqësit e vendeve socialiste të shkonin në Moskë dhe këtu kishte parasysh se Enver Hoxha do ta refuzonte një gjë të tillë, ndaj nuk e rekomandonte.²⁶ Ajo çfarë rekomandohej ishte thirrja e Këshillit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës ku Shqipërisë i propozohej të merrte pjesë me një zëvendëskryetar të Këshillit të Ministrave, kurse vendet joanëtare (ku bënte pjesë edhe Kina) të dërgonin vëzhgues. Po kaq e kujdesshme ishte përgjigjja kineze ndaj propozimit shqiptar që deklarata e 31 korrikut e bërë nga Kina të vihej në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së OKB-së si propozim shqiptar. Ajo nuk e miratoi këtë propozim me argumentin e një mbështetjeje sipas situatës.²⁷

Qeveria shqiptare përgatiti një material drejtuar Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, edhe pse *de facto* prej vitit 1961 nuk merrte pjesë në mbledhje. Materiali kishte tone akuzuese ndaj

²⁴ *Po aty*, fl. 12.

²⁵ *Po aty*.

²⁶ *Po aty*, fl. 11.

²⁷ *Po aty*, fl. 15.

qeverisë sovjetike se po i kryente negociatat “në shpinë” të RPSH-së, e cila as nuk ishte pyetur dhe as nuk ishte informuar.²⁸ Qëndrimi i ashpër i qeverisë shqiptare, edhe pse këshillohej të vepronte me maturi ishte në interes të Kinës, që ishte në kulmin e punës për përgatitjen e bombës atomike. Në deklaratën e qeverisë shqiptare të 15 gushtit 1963, traktati u dënua si një hallkë e rrezikshme e komplotit imperialisto -revizionist.²⁹

Duke përdorur Shqipërinë si kundërshtar të hapur të politikave të bashkëpunimit mes Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-së në fushën e çarmatimit, Kina përcillte në mënyrë indirekte mesazhin se armët bërthamore nuk mund të ishin vetëm monopol i Fuqive të Mëdha. Tirana, gjithashtu, ishte entuziaste për arritjet e Kinës në zhvillimin e armës atomike.³⁰ Mendojmë se, ashtu si në rastin e Bashkimit Sovjetik, pas kësaj mbështetjeje fshiheshin arsye të pastra pragmatiste të përfitimit në fushën e teknologjisë ushtarake. Kjo vërehet edhe në formulimin që do t’iu bëhej më vonë kërkesave për armatim nga Kina, në kushtet e nevojës urgjente për të mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e saj tokësor nga sulmet e revizionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë.

Shqipëria në kërkim të një traktati të sigurisë kolektive me Kinën

Qëndrimi kinez në lidhje me çështjet ushtarake apo me diplomacinë e mbrojtjes Kinë-Shqipëri u karakterizua që në takimet e para e në vazhdimësi nga një faktor kyç. Shqipëria, edhe pse kishte ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Bashkimin Sovjetik, vazhdonte të ishte e angazhuar në një traktat kolektiv shumëpalësh sigurie, Traktatin e Varshavës. Vetë sjellja e qeverisë shqiptare ishte ajo e lojës së strucit: brenda *de jure* dhe jashtë *de facto*. Pikërisht këtë lojë amatoreske Pekini e kishte të qartë, ndaj që në takimet e para nga figurat më të rëndësishme të udhëheqjes kineze u kristalizua haptazi ideja se nuk do të ndërhyjnë në çështjet e mbrojtjes së Shqipërisë, pasi ajo ishte anëtare e Traktatit të

²⁸ *AMPJ*, V. 1964, D. 588, fl. 2. Material lidhur me Traktatin e Varshavës.

²⁹ *Po aty*, fl.7. Material lidhur me Traktatin e Varshavës.

³⁰ *AQSH*, F. 14/AP-MP, V. 1963, D. 17, fl 3. Takim i Enver Hoxhës me delegacionin e shoqërive sportive dhe mbrojtjes së RPK-së kryesuar nga kolonel Li Da, më 10 dhjetor 1963. Edhe pse delegacioni u përkiste shoqërive sportive, pjesa më e madhe e bisedës së zhvilluar me delegacionin ushtarak kinez u bë lidhur me përballjen e Kinës për problemin e bombës atomike me Bashkimin Sovjetik dhe SHBA-në. Enver Hoxha shprehu bindjen se prodhimi i bombës nga Kina ishte çështje me “sot dhe nesër”.

Varshavës. Ndihma do të kufizohej në veshje dhe armatim, për gjysmën e efektivëve.³¹

Për të kuptuar qëndrimin kinez në lidhje me anëtarësimin e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës, është e nevojshme të analizohet së pari edhe vetë raporti që Kina kishte me këtë organizatë.³² Një shqyrtim të qartë të këtij raporti bën studiuesi Lorenz Lüthi.³³ Ai del në përfundimin se qëndrimi i Kinës ndaj Traktatit të Varshavës mbeti gjatë gjithë kohës i dyzuar. Kjo qasje buronte sipas Luth-it nga vetë natyra ambigue e partneritetit kinezo-sovjetik.³⁴ Ajo kishte natyrë utilitare dhe lidhej ngushtë me nevojat e ushtrisë kineze për modernizim. Pikërisht, marrëveshjet për transferimin e teknologjisë së re moderne ushtarake do ta afronin Kinën me Traktatin e Varshavës në harkun kohor 1955-57, aq sa Hrushovi do të bëhej avokat i një shkrirjeje të aleancës kinezo-sovjetike me këtë traktat, me synim integrimin e Kinës në këtë organizatë.³⁵ Mirëpo dështimi i transferimit të këtyre teknologjive, për shkak të ndryshimeve të shpejta që ndodhën në harkun e viteve 1959-1963 në politikën e jashtme të Bashkimit Sovjetik, do të bënte që Kina të shfrytëzonte çarjen BS-Shqipëri të vitit 1961 edhe në raport me Traktatin e Varshavës.³⁶

Për sa i përket RPSH-së, që prej mbledhjes së 28 marsit të vitit 1961 deri në shtator të vitit 1968, mënjanimi nga Traktati i Varshavës u përdor si pretekst. Në këtë periudhë Shqipëria nuk ndërmori asnjë nismë për afrim, apo nismë për të dalë nga kjo organizatë, edhe pse iu mohua e drejta legjitime e pjesëmarrjes. Natyrshëm lind pyetja, përse Shqipëria

³¹ *Po aty*, F.14/AP-MPKK, V. 1961, D. 1, fl. 1. Bisedë mes Çu En Lait dhe Spiro Kolekës, 17 janar 1961.

³² Republika Popullore e Kinës dhe Bashkimi Sovjetik kishin nënshkruar një traktat aleance dypalëshe miqësie më 14 shkurt 1950. Në Traktatin e nënshkruar në Varshavë, më 11 maj 1955, Kina ruajti rolin e vëzhguesit. Bashkimi Sovjetik, referuar Lüthi-t, duke qenë se ishte pjesë e të dyjave, pra edhe traktatit dypalësh, edhe si drejtues i Traktatit të Varshavës luajti një rol përcaktues në këto dy aleanca.

³³ Lorenz M. Lüthi, "The People's Republic of China and the Warsaw Pact Organization, 1955-63", *Cold War History* 7, no. 4 (2007): 479-494; shih gjithashtu: Zihua Shen & Yafeng Xia, "Between Aid and Restriction: Changing Soviet Policies towards China's Nuclear Weapons Program: 1954-1960", *Nuclear Proliferation International History Project, Working Paper 2* (Wilson Center: May 2012).

³⁴ *Po aty*, 480.

³⁵ *Po aty*, 481.

³⁶ *Po aty*, 489.

nuk e hodhi këtë hap? *Së pari*, rol frenues luajti klauzola ligjore që e lidhte Shqipërinë me këtë traktat. Traktati ishte nënshkruar për një periudhë kohore prej 20 vjetësh.³⁷ Për ta denoncuar traktatin Shqipërisë i duhej një ngjarje madhore, me anë të së cilës mund të justifikonte veprimin e saj. Largimi i sovjetikëve nga baza e Vlorës nuk e cenonte integritetin e Shqipërisë. Po kështu, edhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik nuk ishte një argument ligjor për denoncimin e traktatit. Mungesa e një argumenti ligjor ishte pengesë për të ndërmarrë këtë hap. Prandaj edhe vetë udhëheqja shqiptare përsëriste në mënyrë të vazhdueshme se, që prej vitit 1961, kishte pasur të drejtën morale të dilte nga traktati. Madje, problemi ishte diskutuar në Byro disa herë.³⁸ Në këto diskutime ishte arritur në përfundimin se ky hap nuk ishte hedhur pasi qeveria shqiptare ishte në pritje të momentit të përshtatshëm, për të grumbulluar më shumë fakte për të demaskuar udhëheqjen sovjetike.³⁹ Një ngjarje e tillë nuk ndodhi të paktën deri në vitin 1968.

Së dyti, ndërprerja e marrëdhënieve me BS-në u shoqërua me një frikë të vazhdueshme për një sulm të mundshëm nga vetë Bashkimi Sovjetik në emër të Traktatit të Varshavës, por më i mundshëm u pa një sulm nga Jugosllavia me nxitjen e sovjetikëve.⁴⁰ Për udhëheqjen

³⁷ Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës* (disertacion); shih gjithashtu: *AQSH*, F. 489, V. 1955, D. 11, fl. 9. Kopje e Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë, Republikës Popullore të Bullgarisë, Republikës Popullore të Hungarisë, Republikës Demokratike Gjermane, Republikës Popullore të Polonisë, Republikës Popullore të Rumanisë, Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Republikës Çekosllloake; shih gjithashtu: *AMPJ*, V. 1955, D. 293, B. VI-3, fl. 1-8.

³⁸ *AQSH*, F.14/AP-OU, V. 1963, D. 12, fl. 27. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike. Përgatiten tezat për diskutim me shokët kinezë. Një nga pikat që do të diskutohej ishte dalja nga Traktati i Varshavës; shih gjithashtu: Ana Lalaj, “Shqipëria: “Nga Pakti i Varshavës në NATO”, në *Studime historike*, nr. 3-4 (2008):184.

³⁹ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1968, D. 1, fl. 132. Fjala e Mehmet Shehut në Plenumin V të KQ të PPSH-së, 5 shtator, viti 1968.

⁴⁰ *Po aty*, F. 14/MPKK, V. 1963, D. 6, fl. 3. Biseda e Beqir Ballukut me Çu En Lain, 30 shtator 1963. Udhëheqja shqiptare kishte frikën e ndërhyrjes së trupave të Traktatit të Varshavës në Shqipëri si në rastin e Hungarisë, dyshim ky i shprehur edhe gjatë bisedimeve nga Beqir Balluku. “Jugosllavia mund të bëjë provokacione për të krijuar incidente, kështu që TV mund të ndërhyjë dhe të bëhet Shqipëria një Hungari e dytë.”; shih gjithashtu: Hamit Kaba, “Konflikti shqiptaro-sovjetik në optikën e fqinjëve”, në *Studime historike*, nr.1-2 (2010): 82. Sipas burimeve të Departamentit Amerikan të Shtetit, ambasada amerikane në Romë, më 22 janar 1963 raportonte mbi dyshimet

shqiptare mospjesëmarrja e Shqipërisë në sesionet e Traktatit të Varshavës ishte parë si një përjashtim *de facto*. Ky fakt sipas qeverisë shqiptare nuk ishte shpallur botërisht, pasi vendet anëtare nuk donin të merrnin përgjegjësinë përpara opinionit publik për një veprim të tillë dhe sepse ata në një kohë të volitshme mund ta përdornin traktatin kundër Shqipërisë.⁴¹ Hapi drejt denoncimit do të ishte një mundësi për t'i bërë më të lehta këto plane hipotetike. I vetmi rast kur Shqipëria mund të justifikonte daljen nga traktati ishte kur ajo të rrezikohej nga një sulm i mundshëm. Qeveria shqiptare do ta denonconte këtë traktat vetëm në rast rreziku imediat, atëherë kur Traktati i Varshavës të përdorej nga revizionistët si pretekst dhe instrument për të sulmuar ushtarakisht indirekt ose direkt territorin shqiptar.⁴² Gjykimi i udhëheqjes shqiptare në këtë situatë ishte që të mos bëhej asgjë nga ana e saj për të denoncuar traktatin e aleancës që kishte me BS-në dhe vendet e tjera socialiste. Por njëkohësisht ajo nuk kishte besim, përkundrazi, mendonte se duhej të qëndronte gjithmonë vigjilente, pasi në bazë të këtyre traktateve formale, revizionistët mund ta pengonin e ta rrezikonin.⁴³

Faktori i tretë dhe jo më pak i rëndësishëm që luajti rol në mosdenoncimin e traktatit, ka qenë këmbëngulja e kinezëve, që Shqipëria të vazhdonte të mbetej pjesë e kësaj organizate politiko-ushtarake dhe të mos e denonconte e para atë, si dhe të mos angazhohej vetë në një traktat aleance me Shqipërinë që mund ta shtynte këtë të fundit, drejt hapit të daljes nga traktati.⁴⁴ E zënë juridikisht në kurth, me një traktat që ekzistonte në letër, por që e kishte pothuajse të pamundur ta denonconte dy vjet pas përjashtimit *de facto* nga Traktati i Varshavës, Shqipëria u vu në kërkim të një traktati të ri aleance. Këtij qëllimi do t'i shërbente vizita e ministrit të Mbrojtjes Beqir Balluku në Kinë, në gusht të vitit 1963. Para nisjes së tij për në Kinë u punua një material i gjatë që do t'i paraqitej udhëheqjes kineze. Pjesë e tij do të ishte kërkesa për nënshkrimin e një traktati me Kinën dhe nënshkrimi i një traktati mes

italiane në lidhje me planet jugosllavo-sovjetike për rrëzimin e regjimit të Enver Hoxhës.

⁴¹ AQSH, F.14/AP-OU, V. 1968, D. 12, fl. 40. Mbi dërgimin e anëtarit të Bashkimeve Profesionale dhe ministër i Mbrojtjes shokut Beqir Balluku në RPK. “Teza mbi disa çështje për të biseduar me shokët e udhëheqjes së PKK”.

⁴² *Po aty*, fl. 40.

⁴³ *Po aty*, fl. 39.

⁴⁴ Kaba, “Konflikti shqiptaro-sovjetik”, 169.

Kinës, Shqipërisë, Koresë, Vietnamit (dhe Kubës).⁴⁵ Për udhëheqjen shqiptare kjo kërkesë buronte nga fakti se të dyja traktatet, të cilat ajo kishte nënshkruar deri në këtë kohë me Bullgarinë dhe vendet anëtare të Traktatit të Varshavës, nuk ishin aspak garanci për të. Sipas palës shqiptare, kërkesa e saj për një traktat aleance me Kinën, nuk do ta detyronte Republikën Popullore të Kinës që të hynte në luftë në rast se sulmohej Shqipëria. Ky traktat shihej nga pala shqiptare si një instrument frenues ndaj agresorëve.⁴⁶ Problemi i traktateve dhe qëndrimi ndaj Traktatit të Varshavës u prek në bisedimet që Beqir Balluku zhvilloi me Çu En Lain dhe Ten Hsiao Pinin.

Çu En Lai i gjeti të pabazuara argumentet e përfaqësuesit të delegacionit shqiptar në lidhje me sulmet e mundshme ndaj Shqipërisë. Për të, ideja e sulmit nuk ishte një gjë e kollajtë.⁴⁷ Po kështu, lidhur me mundësinë e nënshkrimit të traktatit të mossulmimit mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, Çu-ja mendonte se mundësitë e realizimit të tij ishin të pakta. Ndaj ai e këshilloi Ballukun se, e mira ishte që Shqipëria të mos largohej nga organizata, përpara se ky traktat të nënshkruhej [të ndodhte një gjë e tillë].⁴⁸ Për sa i përket nënshkrimit të një traktati me Kinën kjo do të thoshte sipas Çu En Lait, t'i jepej pretekst armiqve se gjoja ata [kinezët dhe shqiptarët] shkaktonin përçarjen. Në mënyrë tepër diplomatike ai i bëri të ditur palës shqiptare se nënshkrimi i një traktati kërkonte shumë kujdes. "Ne mejtojmë më shumë për punë konkrete jo për forma."⁴⁹

Neni 7 i Traktatit të Varshavës, ku Shqipëria aderonte akoma, e detyronte Shqipërinë të mos merrte pjesë në asnjë koalicion apo aleancë dhe të mos përfundonte marrëveshje, qëllimet e të cilave ishin në kundërshtim me këtë dokument. Kjo klauzolë ka qenë e qartë për Kinën që nuk merrte pjesë në traktat, por ishte vëzhguese. Edhe në bisedimet me Ten Hsiao Pinin, ky i fundit përcolli mesazhin se këto çështje janë

⁴⁵ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1968, D. 12, fl. 45.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ *Po aty*, F.14/MPKK, V. 1963, D. 6, fl.19. Sipas Çu En Lait, një sulm i tillë do të shkaktonte një tronditje në tërë botën.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 27.

⁴⁹ *Po aty*.

relativisht të komplikuar.⁵⁰ Në takimet e para ai e shmangu bisedën në lidhje me traktatin.

“Për çështjen e fundit, domethënë për traktatin midis Kinës dhe Shqipërisë, dhe midis Kinës, Shqipërisë, Koresë, Vietnamit ka kohë për t’i shfrytëzuar në të ardhmen.”⁵¹

Ten Hsiao Pini e pranoi paraqitjen e palës shqiptare mbi situatën, por që në fillim ai e bëri të qartë se pala kineze do të shprehte mendimin e saj, që jo domosdoshmërisht përputhej me atë çfarë udhëheqja shqiptare pasqyrore dhe propozonte.⁵² Në lidhje me shfrytëzimin e Traktatit të Varshavës kundër Shqipërisë nga ana e Hrushovit, si një instrument agresiv, Ten Hsiao Pini mendonte ndryshe. Sipas tij, pretendimet e delegacionit shqiptar nuk kishin një bazë konkrete. Tëni arsyetonte, se, që të ndodhte një ndërhyrje e Traktatit të Varshavës në Shqipëri, në emër të mbrojtjes së integritetit, duhej që më parë të ekzistonin premiset që do ta justifikonin këtë ndërhyrje. Një premisë e tillë bindëse do të ishte një sulm i mundshëm nga Amerika. Vetëm në këtë rast, në bazë të angazhimeve të marra në nenin 4 të traktatit, Bashkimi Sovjetik së bashku me shtetet anëtare do të ndërmerrnin një aksion ushtarak. Por pyetja që ngrinte në këtë rast udhëheqësi kinez si një politikan me shumë eksperiencë ishte: po a mund të dalë në luftë ballë për ballë Bashkimi Sovjetik me SHBA-në? A mund ta ketë këtë guxim Hrushovi?⁵³

Përgjigjja ishte e qartë që Bashkimi Sovjetik nuk do të hynte në një përballje të tillë për Shqipërinë. Zgjidhja më e mirë në këto kushte për kinezët ishte mosdalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës. Ata e konsideronin gjendjen ndërkombëtare të favorshme për ruajtjen e kësaj lidhjeje. Qasja e Kinës se, pavarësisht konflikteve të hapura që ajo kishte

⁵⁰ *Po aty*, F.14/ MPKK, V. 1963, D.7, fl. 30. Biseda e datës 10 shtator, mes Beqir Ballukut dhe Ten Hsiao Pinit.

⁵¹ *Po aty*, fl. 65. Biseda e datës 24 shtator, mes Beqir Ballukut dhe Ten Hsiao Pinit.

⁵² *Po aty*, fl. 77. Ten Hsiao Pini pranoi rreziqet që i kanoseshin Shqipërisë nga tri drejtimet. Por, në dallim me palën shqiptare që këmbëngulte për sulme ndaj Shqipërisë, për të situata në botë ishte e tillë që nuk sillte rreziqe për Shqipërinë. Gjatë bisedës ai paralelizoi situatën në Kubë me rastin e Shqipërisë, duke përcjellë mesazhin te udhëheqësit shqiptarë, që sulmet që ata presupozonin ishin me pak gjasa të mundshme. “Përderisa SHBA nuk po sulmojnë Kubën që ndodhet vetëm disa milje larg, është e qartë se një gjë të tillë nuk mund ta bëjë kundër Shqipërisë, qoftë edhe me anë të Flotës së Gjashtë, qoftë edhe me anën e Greqisë.”

⁵³ *Po aty*, fl. 78.

me sovjetikët, kinezët nuk e mendonin denoncimin e traktatit kino-sovjetik⁵⁴ iu transmetua nga Ten Hsiao Pini si këshillë edhe delegacionit shqiptar. Aderimi në traktat do t'i detyronte vendet anëtare të tij të angazhoheshin përkrah Shqipërisë në rastin e një sulmi të jashtëm mbi Shqipërinë. “Po të ndodhi diçka, - teorizonte Teni, - ato janë të detyruar të shprehin opinionin publikisht.”⁵⁵ Ten Hsiao Pini i kërkoi delegacionit shqiptar, që qeveria shqiptare të tregojë e kujdesshme në demaskimin e Traktatit të Varshavës si dhe traktatit të mossulmimit* [ndërmjet Traktatit të Varshavës dhe NATO-s], për të cilin udhëheqësit komunistë shqiptarë ishin shprehur hapur se ai ishte një bashkëpunim i imperialistëve me revizionistët. Ai u kërkoi shqiptarëve që të bënin dallimin mes demaskimit të revizionistëve [një veprimtari ku edhe ata vetë ishin angazhuar] dhe demaskimit të traktatit. Ten Hsiao Pini iu tërhoqi vëmendjen bashkëbiseduesve shqiptarë që të ndanin marrëveshjet ideologjike nga logjika e zhvillimeve.

“Ju duhet t'i trajtoni këto çështje duke u nisur nga gjendja ndërkombëtare, nga zhvillimi i përgjithshëm i saj.

Nga kjo pikëpamje është mirë që ju të vazhdoni të mbani ato lidhje që kanë mbetur me traktatin, të mos ju jepni atyre pretexte ta dëbojnë Shqipërinë nga Traktati i Varshavës.”⁵⁶

Pra, qëndrimi në traktat për kinezët duhej të ishte një qëndrim formal, dalja prej të cilit mund të bëhej duke pasur parasysh interesin kombëtar. Dhe, në interes të ruajtjes së balancave, Teni refuzoi me shumë takt traktatin e aleancës mes Shqipërisë dhe Kinës. Duke e trajtuar si një çështje që i takonte perspektivës, ai u ndal gjatë në analizën e efektit që do të kishte nënshkrimi i një traktati të tillë.⁵⁷ Për atë kohë sa Shqipëria

⁵⁴ *Po aty*, fl. 80. Edhe pse mendonin se ky traktat nuk ishte ndonjë gjë e madhe për Kinën, denoncimi i tij nuk ishte një veprim që ata e mendonin si të arsyeshëm.

⁵⁵ *Po aty*.

* Qëndrimi ndaj kësaj çështjeje për Ten Hsiao Pinin ishte një çështje taktike dhe duhej vepruar me takt.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 80.

⁵⁷ Ten Hsiao Pini e hodhi poshtë argumentin shqiptar, sipas të cilit nënshkrimi i një traktati aleance nuk e detyronte Kinën të futej në luftë për Shqipërinë. Ai i argumentoi Ballukut se bërja e një traktati të tillë, do të influenconte të dyja shtetet në politikën e tyre të jashtme. “Ne mejtajmë se po të bëhet një traktat i tillë, kjo do të ketë pasoja njëjloj si për ju, ashtu edhe për ne. Për shembull, për çfarë veprimi do të marrin ata

ishite anëtare e Traktatit të Varshavës kjo mund të shihej si një kundërvënie e hapur me këtë traktat.

“Në qoftë se do të nënshkruhet një traktat mes Kinës dhe Shqipërisë armiqtë do të mbajnë parasysh telashtet që ne mund t’u shkaktojmë atyre në rast se ata sulmojnë Shqipërinë.

Por për të njëjtat arsye ata mund të shkaktojnë ndonjë provokacion kundër jush për të na krijuar telashe neve dhe anasjelltas.”⁵⁸

Është e qartë se në këtë rast me “armiç dhe sulm” nuk nënkuptonte vetëm NATO-n, por edhe vetë organizatën ushtarake të Kampit Komunist dhe Bashkimit Sovjetik. Si konkluzion në lidhje me kërkesën shqiptare për një traktat aleance, por edhe për qëndrimin që duhej mbajtur ndaj Traktatit të Varshavës nga ata, Ten Hsiao Pini bëri të qartë se një traktat aleance nuk mund të koordinonte veprimet. Aq sa me dobi mund të dukej ky traktat, aq edhe dëm mund të kishte. Kështu që një kërkesë e tillë, duhet të vihej në rendin e ditës për të ardhmen. Në këtë mënyrë kjo do të ishte në përputhje edhe me lidhjet që do të mbanin me Traktatin e Varshavës.⁵⁹

Përgjigje refuzuese mori edhe propozimi për krijimin e një aleance: Kinë, Shqipëri, Kore, Vietnam, ndoshta edhe me përfshirjen e Kubës. Nëse mes Kinës, Koresë dhe Vietnamit shkëmbimi i ndihmës kishte sens për Ten Hsiao Pinin “njësoj është të ndihmojnë vendet tona me traktat apo pa traktat”,⁶⁰ për Shqipërinë një angazhim i tillë direkt ishte i pamundur. Kina do të ishte shumë e kujdesshme në hedhjen e një hapi të tillë, edhe në rastin më pak të mundshëm të nënshkrimit të një traktati mossulmimi mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Nënshkrimi i një traktati aleance me Shqipërinë shihej nga udhëheqësit kinezë si një rrezik potencial, që të shtoheshin pretekstet për luftë kundër Shqipërisë. Beqir Balluku, i ndodhur përpara një refuzimi të tillë, këmbënguli në idenë se Traktati i Varshavës nuk ishte më efektiv për Shqipërinë. Ai shprehu bindjen e qeverisë shqiptare se traktati në fjalë tashmë ishte një instrument që mund të vepronte në të keqen e Shqipërisë.⁶¹ Pas kësaj

kundër jush ne do të influencohemi dhe për çdo veprim që do të marrin ata kundër nesh ju do të influencoheni”.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 81.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 82.

⁶¹ *Po aty*.

tentative të dështuar, qeveria shqiptare nuk ndërmori më nisma për aleanca ushtarake me Kinën. Ajo mbeti formalisht siç u këshillua nga kinezët pjesë e Traktatit të Varshavës, por nuk ndoqi këshillën për të ndalur demaskimin e tij, ku vazhdonte të ishte anëtare. Gjithë politika e mbrojtjes së shtetit shqiptar u fokusua te marrja e sa më shumë ndihmave ushtarake, duke përfituar edhe nga konteksti gjeopolitik dhe duke e vendosur veten si “barrikadë” në luftën me revizionizmin dhe kapitalizmin.

Gjatë vitit 1967, ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku do të realizonte një ndër vizitat më të suksesshme në Kinë për sa i përket marrjes së ndihmave ushtarake. Ashtu sikurse ai vetë do të raportonte në mbledhjen e Byrosë Politike, furnizimi që do të realizohej sipas marrëveshjes ishte i kënaqshëm për palën shqiptare dhe nga 450 milionë të parashikuara mendohej se këto ndihma do të kapnin shifrën prej 410 milionë rubla.⁶²

Përgjigjja kineze ndaj sulmeve imagjinare ndaj Shqipërisë pas denoncimit të Traktatit të Varshavës

Vendimi për daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës u mor më datën 5 shtator 1968 në Plenumin e Komitetit Qendror të PPSH-së. Qeveria kineze do të vihej në dijeni për këtë vendim të palës shqiptare përmes të Ngarkuarit të saj me Punë në Shqipëri, Li Xhu Hsuan më datë 6 shtator 1968, në takimin e organizuar nga Kryeministri Mehmet Shehu. Ashtu siç është e njohur në trajtesën që i është bërë në historiografinë shqiptare këtij momenti, Mehmet Shehu e argumentoi këtë vendimmarrje para Li Xhu Hsuan si një akt që u hiqte çdo mundësi revizionistëve sovjetikë për të pushtuar Shqipërinë.⁶³

⁶² *AQSH*, F.14/AP-OU, V. 1967, lista 1, D. 5, fl. 48-51. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike mbi rezultatet e vizitës në Kinë të delegacionit ushtarak shqiptar të kryesuar nga shoku Beqir Balluku dhe mbi takimet që bëri shoku Hysni Kapo me rastin e vajtjes atje për arsye shëndetësore.

Ndihma materiale e kërkuar nga pala shqiptare kapte vlerën e 600 milionë rublave. Në këtë ndihmë përfshiheshin 300 tanke, nga të cilat u dhanë 265. Nga 1 000 mitraloza katërgrykësh që kërkuan, u dhanë vetëm 200. Kaq u dhanë edhe për mitraloza me 2 grykë, 500 me një grykë. Pala kineze ofroi për ushtrinë shqiptare në këtë takim gjithashtu 3 skuadrilje avionësh, 2 Mig 19, 1 Mig 21.

⁶³ *AMPJ*, V. 1968, D. B/I-10, fl. 107-112; shih gjithashtu: Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës* (disertacion).

Dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës u pasqyrua gjerësisht në mjetet e propagandës të Republikës Popullore të Kinës. Gazeta “Cefancjunbao” i përcolli popullit shqiptar mesazhin e kryetarit Mao dhe udhëheqësve të tjerë të Kinës. Ata shprehnin përgëzimet e zjarra për veprimin revolucionar të Shqipërisë.⁶⁴ Në mbështetje të popullit shqiptar, artikulli i gazetës “Cefancjunbao”, shprehte angazhimin e Kinës komuniste kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik. Nëse ata do të guxonin t’i preknin qoftë edhe një fije floku Shqipërisë, atëherë ata i priste një disfatë e plotë, e turpshme dhe e pashmangshme.⁶⁵

Por, pavarësisht deklaratave në shtypin kinez, dalja e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës nuk e lehtësoi pozitën e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Ajo mbeti një vend i izoluar komunist ku psikoza e një sulmi nga jashtë arriti deri në kufijtë e marrëzisë, duke imagjinuar një bashkëpunim mes Traktatit të Varshavës dhe NATO-s.⁶⁶ Në të njëjtën ditë kur u bë edhe shfuqizimi i Traktatit të Varshavës nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë, Mehmet Shehu informonte se mbrojtja e vendit nga një agresion i jashtëm ishte organizuar në variantin më të vështirë dhe plani operativ i mbrojtjes ishte aprovuar nga Këshilli i Mbrojtjes dhe ishte firmosur nga Enver Hoxha një vit më parë se të ndodhte pushtimi i Çekoslovakisë.⁶⁷

Një muaj pas denoncimit të Traktatit të Varshavës nga Republika Popullore e Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes Beqir Balluku do të zhvillonte vizitën e radhës në Pekin. Kjo vizitë, si edhe ato të mëparshmet të trajtuara në këtë punim, kishte në fokus çështjet ushtarake. Për të kuptuar rolin e marrëdhënieve ushtarake në miqësinë mes Kinës dhe Shqipërisë, do të analizojmë takimin e datës 6 tetor 1968, që nisi në orën 21:40 dhe vazhdoi deri në orën 2 pas mesnatës të datës 7 tetor. Në këtë takim krahas Çu En Lait merrte pjesë edhe Huan Jun Shen që

⁶⁴ “Çfarëdo që të ndodhë, populli kinez do të jetë gjithmonë i bashkuar fort me shokët shqiptarë të armëve”, kryeartikull i gazetës “Cefancjunbao”, *Zëri i Popullit*, 21.09.1968, 4.

⁶⁵ *Po aty*.

⁶⁶ *Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura* (më tej: *AQFA*), F. 100/3, Sekretariati, V. 1970, D. 6, fl. 2-15; shih gjithashtu: “Përmbledhje dokumentesh të periudhës së Luftës së Dytë Botërore (1939-1944) dhe Luftës së Ftohtë (1947-1990), *Buletin Arkivor Usharak*, nr. 1-2 (2020): 208.

⁶⁷ *AQFA* F. 100/3, Sekretariati, V. 1970, D. 6, fl. 2.

mbante funksionin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Popullore të Kinës.⁶⁸

Takimi ishte në vazhden e kërkesave të paraqitura më 2 tetor, të cilat ishin të argumentuara se Shqipëria po përgatitej të ishte në gatishmëri për një luftë që paraqitej në dy variante: ajo e një sulmi nga Bashkimi Sovjetik i cili do të mobilizonte të gjitha forcat e vendeve vasale si Bullgaria e Jugosllavia, si dhe të vendeve të tjera reaksionare si Greqia e Italia që do të ishte një luftë më e madhe.⁶⁹

Analiza që Çu En Lai i bën situatës së mbrojtjes së Shqipërisë në kushtet e një sulmi është sa objektive, aq edhe larg këndvështrimit që udhëheqja shqiptare kishte për luftën. Vetë territori i Shqipërisë prej 28 000 km katrorë dhe gjerësia e shkurtër lindje-perëndim bënte që mundësitë e ushtrisë shqiptare për lëvizje të ishin të kufizuara. Kjo e bënte Shqipërinë një shesh luftime [ky ishte varianti më realist], pasi mundësia e pengimit të zbakimit me desant ajror ishte e kufizuar. Duke analizuar variantin e një luftime që synonte të sillte trazira vetëm në Shqipëri, Çu En Lai e klasifikonte këtë mënyrë luftimi si tipologji, një luftë jo të madhe, sipas modelit të luftërave të kufizuara, pra do të ishte një luftë e ftohtë.⁷⁰ Por, nëse kjo luftë do të ishte një luftë e madhe që do të shpërthehej nga revizionistët sovjetikë, në këndvështrimin e tij, kjo do të ishte fillesa e shpërthimit të një luftime të tillë dhe jo e ndonjë provokacioni të armatosur, siç kishin pretenduar udhëheqësit shqiptarë në të kaluarën.⁷¹

Ashtu si edhe në takimet e shkuara, Çu En Lai nuk përjashtonte edhe mundësinë se një luftë e tillë kishte pak gjasa të ndodhte, sidomos bashkëpunimin mes Traktatit të Varshavës dhe NATO-s ai e shihte të vështirë për shkak të kontradiktave që këto dy organizata armike kishin mes tyre. Aq më tepër, në kushtet kur SHBA-ja ishte e angazhuar në luftën e Vietnamit dhe Bashkimi Sovjetik sapo kishte nënshtruar Çekoslllovakinë, sipas tij, reagimi i opinionit publik do të ishte i madh. Të

⁶⁸ AQFA, F. 100/3, Sekretariati, V. 1968, D. 166, fl. 1-8. Protokoll mbi bisedën që u zhvillua midis delegacionit të Partisë dhe qeverisë së RPSH-së të kryesuar nga shoku Beqir Balluku me shokun Çu En Lai, Huan Jun Shen e të tjerë...; shih gjithashtu: Gjon Boriçi, "Kreditë dhe ndihmat kineze për Shqipërinë", në *Studime historike*, nr. 3-4 (2018): 209-210.

⁶⁹ AQFA, F. 100/3, Sekretariati, V. 1968, D. 166, fl. 1.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 2.

⁷¹ *Po aty*.

dyja mundësitë e parashtruara dhe të argumentuara me shumë takt nga Çu-ja synonin të justifikonin se çfarë ndihmash ushtarake kishte vendosur Kina t'i jepte Shqipërisë, e cila ashtu siç kishte vepruar me Bashkimin Sovjetik, sa herë i jepej mundësia paraqiste kërkesa të majme, në emër të mbrojtjes së Kampit Socialist.

Në planin pesëvjeçar, 1965-1970 ishin parashikuar rreth 746 zëra, prej të cilëve Kina do të mbulonte rreth 90% të tyre. Plotësimi i këtyre zërave në industrinë ushtarake, që kishte ndikim të ndjeshëm në kapacitetet mbrojtëse të ushtrisë shqiptare, nuk do të thoshte se Pekini mendonte njëlloj si udhëheqja shqiptare në lidhje me sulmet e mundshme nga jashtë. Çu En Lai nuk hezitoi të ishte i drejtpërdrejtë dhe duke i vënë në dukje se në lidhje me çështjet e parashtruara nga Beqir Balluku në emër të qeverisë shqiptare dhe qeverisë kineze kishte kontradikta.⁷²

Një nga tezat e këtij takimi që paraqet interes studimi është ideja se mundësia e një lufte të madhe shtronte para qeverisë shqiptare nevojën e zgjerimit të saj jashtë kufijve të Shqipërisë.⁷³ Është e rëndësishme shqyrtimi i kësaj teze, pasi doktrina ushtarake shqiptare gjithmonë është mbështetur në parimin defensiv. Po kështu, teza më e elaboruar në historinë tonë kombëtare është se shqiptarët kanë luftuar vetëm për të mbrojtur vendin e tyre. Kështu që prezantimi i një teze për një luftë jashtë kufijve tingëllon pak e çuditshme, sidomos një luftë me dy superfuqi. Mendojmë se teza e Çu En Lait kishte natyrë shkurajuese për kërkesat e paraqitura nga shqiptarët për armë të rënda, si: avionë, topa të kalibrave të mëdhenj, tanke apo automobila. Në mënyrë diplomatike ai tentonte ta drejtonte udhëheqjen shqiptare tek ai model i mundshëm lufte që mund të zbatohet me një ushtri të një vendi të vogël dhe, aq më tepër, me një terren ku mjetet e rënda të motorizuara nuk do të jepnin rezultat.

Modeli i luftës që propozonte Çu En Lai ishte i ngjashëm me luftën guerile të Vietnamit, ku pothuajse nuk u përdorën armët e rënda. Ideja ishte e ngjashme me atë që do të njihej më vonë si teoria e rrëshqitjes, ose

⁷² *Po aty*, fl.3. Konceptin e luftës së madhe Çu En Lai e lidhte më së pari me zhvillimet në arenën ndërkombëtare. Një luftë e tillë ku do të përfshihej edhe Shqipëria mund të nisej nga SHBA-ja pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 1968, ose pasi BRSS-ja të ishte futur në vendet e Europës Lindore. Në këtë kuadër, veprimet luftarake kundër Shqipërisë sipas Çu-së mund të nisnin gjashtëmujorin e parë ose të dytë të vitit 1969. Për këtë përballje qeverisë shqiptare i nevojitej të mendohej thellë për të prishur planet e armikut.

⁷³ *Po aty*.

si u njohën ndryshe “Tezat e Zeza”^{*} të përgatitura nga ata që u quajtën grupi puçist në ushtri në vitin 1974. Ashtu siç parashikohej edhe në artin ushtarak shqiptar një desantim ajror do ta detyronte ushtrinë të tërhiqej maleve për t’u rikuperuar dhe për të kundërsulmuar. Prandaj edhe këshilla e Çu-së ishte të mos synohej armatimi i rëndë, avionë, tanke, automobila pasi ishin të vështira për t’u lëvizur në male apo për t’u fshehur në tunele.⁷⁴ Këshilla e Çu En Lait ishte e papranueshme për një shtet socialist, që me goditjen e parë të armikut të braktiste luftën e rregullt dhe të kalonte në luftën partizane. Kjo teori të cilën Balluku ia kundërshtoi udhëheqësit kinez, do t’i kushtonte atij karrierën e gjatë si ministër i Mbrojtjes dhe jetën.

Të njëjtin gjykim për sa i përket forcës përbaluese të sulmit të armikut me Çu En Lait ndante edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë kineze, Huan Jun Shen. Shqipëria vlerësohej si një vend i vogël që duhej të luftonte kundër vendeve të mëdha. Aftësitë teknike të ushtrisë së saj, si në tokë dhe në ajër, vlerësoheshin më të dobëta se armikut të menduar [Bashkimi Sovjetik dhe NATO].⁷⁵ Edhe ai rekomandonte armët e lehta, të cilat mund të manovroheshin dhe të transportoheshin lehtësisht. Armët e rënda do të ishin target i bombardimeve të armikut dhe për këtë ai i referohej përvojës së luftërave lokale në Kore dhe Vietnam. Duket se nga kjo bisedë u përforcua ideja e luftës popullore dhe planëzimi i luftës përmes armatosjes së gjithë popullit me armë të lehta.

Po kështu, aspekti ekonomik nuk ishte jashtë vëmendjes së Çu En Lait, që kishte parasysh se sasia e armatimit të kërkuar e kalonte gjithë prodhimin vjetor të Kinës. Dhe, mbi të gjitha, Kina nuk do të merrte përsipër akuzën që mund t’i vinte qoftë nga Perëndimi, qoftë nga Kremli se po militarizonte deri në dhëmbë vendin e vogël komunist në Ballkan. Transportimi i një ngarkese ushtarake që shkonte rreth 200 000 ton, do të kërkonte rreth 20 anije me kapacitet 10 000 tonësh dhe kjo do të tërhiqte vëmendjen e gjithë botës sipas Çu En Lait.⁷⁶ Negocimi i ndihmës ushtarake ishte një proces jo shumë i lehtë për delegacionin

* Materiali i përgatitur nga dy teoricienë ushtarakë të lartë, Spiro Shalësi dhe Ernest Jakova, sugjeronte se për një ushtri si ushtria jonë lufta pozicionale ishte e humbur [e kotë, e pamundur], prandaj dhe forcat planifikoheshin të hidheshin në kundërsulm jo të grupuara [për të minimizuar humbjet].

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 7.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 4.

shqiptar. Megjithatë, kredia e miratuar më 20 nëntor 1968 dhe veçanërisht ndihmat ushtarake janë trajtuar si një “varkë shpëtimi” për qeverinë shqiptare, nisur edhe nga vetë entuziazmi i saj.⁷⁷

Ftohja ideologjike dhe ulja e ndjeshme e ndihmave ushtarake

Udhëheqja kineze nuk e fshihte faktin se për sa u përket ndihmave ushtarake Shqipëria mbështetej vetëm te Kina. Kërkesat për ndihma ushtarake falas që vinin gjithmonë duke u bërë edhe më të mëdha nga pala shqiptare, ishin jo pa ndikim në ekonominë e Kinës. Në fillim të viteve '70 në takimet mes palëve po bëhej gjithmonë e më pranishme ideja se në kushtet në të cilat ndodhej Kina, kërkesat e Tiranës, edhe pse nuk ishin shumë të mëdha për ekonominë e zhvilluara, nuk mund të plotësoheshin dot nga Pekini që ishte futur në rrugën e socializmit nga një prapambetje shumë e madhe.⁷⁸ Angazhimi me vendet e tjera komuniste, sipas disa parimeve të shpallura nga udhëheqja kineze, si dhënia e kredive pa interes, zgjatja e afatit të kthimit të kredive si dhe ndihmat ushtarake falas bëheshin mbi bazën e prioriteteve të qarta. Vietnami zinte vendin e parë ku shkonin rreth 30-40% e ndihmave, Shqipëria renditej e dyta dhe e treta Koreja [në ndihmat për Korenë Çu En Lai i referohej periudhës së luftës së Koresë].⁷⁹

Në rastin e Shqipërisë interesi i Kinës për ta përdorur atë si një urë kalimi në Europë kishte rënë ndjeshëm. Ajo nuk ishte më i vetmi vend komunist që ishte rebeluar kundër Moskës. Rumania gjithashtu që prej vitit 1964 kishte shprehur qartë shenjat e një embrioni disidence.⁸⁰ Kina kishte tentuar të krijonte edhe një bosht antisovjetik Beograd-Rumani-

⁷⁷ Gjon Boriçi, “Përpyqjet e qeverisë shqiptare për të arritur industrializimin e vendit me anë të veprave të fundit madhore nga Kina në Shqipëri 1966 -1973”, në *Studime historike*, nr. 1-2 (2021): 295-297. Autori Gj. Boriçi në artikull argumenton se qeveria shqiptare ishte më shumë e gëzuar për ndihmat ushtarake, sesa për kredinë dhe ndihmat ekonomike. Ky argument mendojmë se qëndron, pasi për shkak të psikozës së sulmit të kombinuar të Bashkimit Sovjetik dhe NATO-s qeveria shqiptare jo vetëm kishte rritur ndjeshëm numrin e forcave të armatosura, por përmes procesit të Shkollave të Lira Vullnetare, kishte nisur militarizimin e gjithë jetës së vendit, me parullën “I gjithë populli ushtar”.

⁷⁸ AQFA, F.100/3, Sekretariati, V. 1972, D. 239, fl. 70-03. Nga biseda e shokut Çu En Lai me shokun Beqir Balluku, 1 dhjetor 1972.

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ Laurien Crump, *The Warsaw Pact Reconsidered International Relations in Eastern Europe, 1955-1969* (New York: Routledge, 2015), 85.

Shqipëri por qëndrimet e ashpra të regjimit komunist duket se e zhbënë brenda një dekade miqësinë e ndërtuar mbi ideologjinë. Mbi të gjitha Kina e viteve '70 kishte bërë hapa të paimagjinueshëm në politikën e saj të jashtme, ose siç njihet ndryshe “politika e dyerve të hapura”. Interesat kombëtarë kishin bërë që ideologjia të kalonte në plan të dytë. Po kështu, marrja e përgjegjësive për një aleat të vogël që ishte kundër gjithë botës, nuk ishte pjesë e koniunkturave të një Kine që kërkonte të hynte në zonën e të mëdhenjve.

Është shumë domethënëse qasja pragmatiste që Çu En Lai shfaq në bisedën me Beqir Ballukun në takimin e 1 dhjetorit të vitit 1972 në lidhje me arsyet e armatimit të Vietnamit, përveç interesave ideologjikë dhe atyre gjeopolitikë. Vietnami i shërbeu industrisë së luftës kineze që sa vinte e fuqizohej si një test prove për cilësinë. Këtë ai e pohon kur thotë se, “pa qenë lufta në Vietnam, ne nuk do të kishim mundësinë të provonim cilësinë dhe efektshmërinë e teknikës sonë luftarake. P.sh., fusha e luftës në Vietnam provoi që minat e prodhimit tonë të përdorura aty dolën të një cilësie të dobët dhe difektoze”.⁸¹ Në Shqipëri armatimi kinez shërbeu më shumë si një mjet shantazhi, sidomos ndaj fqinjëve për të treguar një fuqi ushtarake konkurruese në rajon. Kjo ishte një vazhdimësi e politikës së ndjekur nga Bashkimi Sovjetik.

Edhe ky takim zotërohet nga ideja se lufta nuk është një kërcënim real për sovranitetin e Shqipërisë dhe kërkesat për armatim të palës shqiptare nuk i përgjigjen realitetit. Gjithmonë duke iu referuar përparësive të përmendura më sipër, udhëheqësi kinez nuk shihte një luftë të afërt në Europë [një parashikim i provuar] dhe për të Azia mbetej rajoni ku luftërat lokale të tipologjisë ushtarake si luftëra të kufizuara do të vazhdonin të ishin prezente. Prandaj edhe kërkesat për armatim dhe teknikë do të mbeteshin gjithmonë të larta, duke rrudhur ndihmën për Shqipërinë.⁸² Ky takim ka një mbyllje shumë intriguese. Çu En Lai me shumë politesë i kërkoi Beqir Ballukut që si anëtar i Byrosë Politike, zëvendëskryeministër, ministër i Mbrojtjes, pra një udhëheqës i Partisë, pushtetit dhe ushtrisë t'i përcillte Enver Hoxhës se nën shembullin e tij [Enver Hoxha nuk dilte jashtë Shqipërisë që prej mbledhjes së Moskës] nuk shihej e nevojshme apo e udhës nga pala kineze që të vazhdonin të

⁸¹ AQFA, F.100/3, Sekretariati, V. 1972, D. 239, fl. 70-103.

⁸² Po aty.

shkëmbeheshin delegacione të rangjeve të larta për zgjidhjen e problemeve të natyrës së lartpërmendur [ndihmat ushtarake].⁸³

Po në të njëjtin delegacion ishin përfshirë një sërë figurash madhore të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të cilët zhvilluan takime në nivelin teknik.* Takimi i nivelit teknik i zhvilluar në datën 4 dhjetor ishte në vazhden e bisedimeve të nivelit të lartë mes Çu En Lait dhe Beqir Ballukut. Edhe pse në këtë bisedë ishin parashtruar qartë se çfarë problematikash kishte industria e luftës kineze apo se cilat vende kishin prioritet, palës shqiptare iu përcoll mesazhi se dëshira për ndihmë nuk shkonte në të njëjtin kah me mundësitë e Kinës për të përmbushur të gjitha kërkesat e delegacionit shqiptar.⁸⁴ Duket se qeveria kineze ishte e prirë të bënte të njëjtën gjë që bënë sovjetikët në vitet 1959-1960, t'i zvarrisnin kërkesat e paraqitura nga delegacioni shqiptar me argumente të ndryshme, si p.sh., dëmi që ekonomia kineze e luftës kishte pësuar nga Lin Biao, apo cilësia e këtyre prodhimeve që për kinezët akoma nuk ishte në standardin e dëshiruar.** Mbi këto argumente ushtarakët kinezë kërkuan që kërkesat shqiptare të përpunoheshin për një plan 3-vjeçar 1972-1975. Protokollin e kësaj marrëveshjeje parashikonte dhënien falas të ndihmës teknike ushtarake nga Kina.⁸⁵

⁸³ *Po aty.*

* Pjesë e delegacionit ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes ishin Rrahman Parllaku, Mendu Backa, Faik Take, Sul Domi, Abaz Fejzo, Kiço Janko, Januk Dango, Abdi Mati, Gaqo Pojani dhe Qazim Kapisyzi. Të gjithë ishin ushtarakë karriere dhe drejtues të tri forcave kryesore, si: forca tokësore, ajrore, detare apo përfaqësues të Institutit të Projektimit Ushtarak që merrej me fortifikimet.

⁸⁴ *AQFA*, F.100/3, Sekretariati, V. 1972, D. 239, fl. 139-146.

** Në takim Xhan C'haj Cien diskutoi me ushtarakët shqiptarë rreth problematikave të raketave tokë-ajër, efektivitetin e tyre të ulët në goditjen e avionëve armiq, problemet me kapjen e radiozhurmave të armikut etj.

⁸⁵ *AQFA*, F. 100/3, Sekretariati, V. 1972, D. 239, fl. 139-146.

Lista që mendohej të përfshihej në protokoll, parashikonte ndihmë ushtarake si më poshtë:

- 262000 copë pushkë;
- 3782 topa të kalibrave të ndryshëm;
- 36 copë avionë të tipave të ndryshëm;
- 18 copë anije ushtarake;
- 150 copë tanke të tipit të mesëm;
- 43 copë radiolokatorë të tipave të ndryshëm;
- 1521 copë automjete të ndryshme dhe materiale e pajisje përkatëse.

Për të gjitha kërkesat u bë e qartë se nuk do të merrnin zgjidhje përpara vitit 1975. Të njëjtin fat do të kishin edhe kërkesat për vepra të plota ushtarake [nënkuptoreshin aeroporte, bazime detare etj. – E. S]. Përgjigjja e palës kineze ishte se ajo nuk pati mundësi të merrte angazhime për t'i plotësuar ato. Togfjalëshi “këto çështje t’ja lëmë të ardhmes” ishin pjesë e përsëritur e bisedimeve.⁸⁶ Ushtarakët shqiptarë me shumë gjasa kanë parë në këtë takim *déjà vu*-në e takimit të 18 tetorit të vitit 1960 në Moskë, ku për shkak të tensionimit të marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë, reduktimi dhe zvarritja e ndihmave ushtarake do të ishte tepër e madhe dhe me kosto për kapacitetet e mbrojtjes.⁸⁷ Rahman Parrllaku do t’i deklaronte homologut të tij kinez, Khan C’haj Cien se “ushtrinë e kemi të zbathur dhe të ç’veshur”.⁸⁸

Vizita e fundit ushtarake në Kinë është ajo e Veli Llakajt, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Popullore në vitin 1975. Asnjë nga figurat madhore, duke nisur nga Beqir Balluku e deri tek ish-gjeneralët që kishin qenë pjesë e delegacioneve zyrtare nuk ishte më pjesë e forcave të armatosura. Ata ose ishin ekzekutuar, ose ishin në burg, ose në internim. Madje, dënimi i Beqir Ballukut shërbeu si një justifikim për kërkesat për ndihma ushtarake që do të materializoheshin në letrën që Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu dërguan tek udhëheqësit kinezë më 12 nëntor 1975.⁸⁹ Letra e mësipërme është analizuar në një prej punimeve të studiuesit Gjon Boriçi, në revistën “Studime historike”.⁹⁰ Dokumenti i marrë në shqyrtim paraqet një skenar viktimizimi të udhëheqjes shqiptare, ngritur mbi një sulm imagjinar ndaj Shqipërisë ku përfshihen si aktorë Traktati i Varshavës dhe NATO. Ngjashmëria është e njëjtë me planin operacional të një sulmi të kombinuar nga ajri, toka dhe deti që analizohet në këtë punim për ngjarjet e vitit 1968. Vizita e Veli Llakajt mund të quhet plotësisht e dështuar. Motoja kineze se Shqipëria ishte e paaftë të mbrohej nga një sulm sovjetik ishte argument se asnjë armatim, qoftë

⁸⁶ Po aty; shih gjithashtu: *AQSH*, F. 14, V. 1971, D. 2; Biberaj, *Shqipëria dhe Kina*, 111.

⁸⁷ Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës* (disertacion), 110-116.

⁸⁸ *AQFA*, F. 100/3, Sekretariati, V. 1972, D. 239, fl. 139-146.

⁸⁹ Boriçi, “Kreditë e fundit kineze”: 267.

⁹⁰ *Po aty*, 268. Studiuesi Boriçi shpjegon se letra nuk mori përgjigje dhe del në përfundime të qarta që udhëheqja kineze ishte distancuar tashmë plotësisht nga psikozat e luftës së madhe të regjimit të Tiranës.

edhe ai i rëndë e modern nuk mund ta shpëtonte atë nga pushtimi nëse do të ndodhte një agresion i mundshëm.

Përfundime

Aleanca Kinë-Shqipëri u farkëtua në një shtrat Prokusti, në një skemë jonatyrle dhe të sforcuar në marrëdhëniet ndërkombëtare. Krahas zhvillimit të industrisë së rëndë, militarizimi me hapa të shpejtë i vendit ishte produkti më i prekshëm i bashkëjetesës së shkurtër të të dyja vendeve që i bashkoi dhe i ndau ideologjia komuniste. Që prej fillimit Shqipëria i shërbeu Kinës si një vend europian, ku ajo sendërtoi përplasjen e saj me Moskën. Këtij shërbimi dhe ndihmës së zellshme të Shqipërisë për t'i hapur rrugën drejt OKB-së, Kinës komuniste, kjo e fundit iu përgjigj me një sasi të madhe armatimi të lehtë dhe të rëndë. Por kjo bujari në materiale ushtarake, nuk shkoi paralel me angazhimin në traktate dypalëshe për mbrojtjen, përkundrazi, një i tillë nuk u mor kurrë në konsideratë nga Kina edhe në ditët më të mira të marrëdhënieve dypalëshe.

Etja për armatim e qeverisë shqiptare asnjëherë nuk gjeti mbështetjen e Kinës, e cila pati gjithmonë një qasje të ndryshme për luftën nga regjimi i Tiranës. Por, ashtu siç e përmendëm edhe më lart, kjo ndihmë ishte haraçi që duhej të paguante Pekini për 'delen e zezë' të Traktatit të Varshavës, që braktisi Moskën për hir të tij. Në marrjen e ndihmave ushtarake, Shqipëria komuniste përdori pothuajse të njëjtat taktika që kishte përdorur edhe me Bashkimin Sovjetik. Ajo i mëshoi rrezikut që i kanosej si i vetmi vend socialist në luftë me revizionizmin dhe imperializmin, si dhe rrezikut që i kanosej nga fqinjët. Këto ndihma në të shumtën e marrëveshjeve u shoqëruan me falje të kredive dhe në kundërshtim me retushimin që iu bë marrëdhënieve Shqipëri-Kinë pas prishjes së tyre. Në ndihmat që jepte Kina për vendet komuniste, Shqipëria renditej e dyta.

Pavarësisht cilësisë së armatimit kinez, të cilën ata e pranonin dhe vetë se nuk ishte në standardet e armatimit të Bashkimit Sovjetik apo Perëndimit, ushtria shqiptare vazhdoi të përdorte mjetet ushtarake dhe armët e të gjitha kalibrave deri në 10-vjeçarin e fundit të shek. XX. Ndhma ushtarake kineze do të shihej si një garanci për regjimin që të zbatonte konceptin doktrinor të mbrojtjes me çdo kusht e çdo pëllëmbë toke dhe bërjes ballë çfarëdolloj armiku apo koalicioni armiqsh, si nga

Traktati i Varshavës apo nga NATO dhe të dilte fitimtare.⁹¹ Por, në të vërtetë, kjo ishte një eufori e pajustificuar.

Në përfundim të këtij punimi, mund të themi se, ndihma ushtarake kineze çoi në militarizimin e tejskajshëm të jetës në vend. Armatosja e gjithë popullit sipas parullës “Çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar” e vendosi gjithë vendin nën psikozën e situatave të një lufte kërcënuese. Ky ndryshim rrënjësor në konceptet strategjike dhe taktike të ushtrisë e bëri më të thjeshtë zbatimin e politikës së izolimit dhe rritjes së frymës së ksenofobisë menjëherë pas prishjes me aleatin e vetëm komunist, Kinën.

Bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondet:

F.14/Arkivi i Partisë – Organet Udhëheqëse, V.1963, D.12; V.1967, D.5; V.1968, D.1, ; V.1971, D.2.

F.14/APMP - Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, V.1958, D. 2.

F.14/ AP – Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës - V.1961, D.1; V.1963, D.5, 6, 7, 17.

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ)

V.1963, D.101; V.1968, D. B/I-10

Traktati i Varshavës - V.1964, D.588

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA)

F.100/3 – Sekretariati V. 1968, D.166; V.1970, D.6; V.1972, D.239.

Botime dokumentare:

Buletini Arkivor Ushtarak, “Përmbledhje dokumentesh të periudhës së Luftës së Dytë Botërore (1939 -1944) dhe Luftës së Ftohtë (1947 -1990), Nr.1-2. Tiranë: 2020.

Boriçi, Gjon. *Shqipëria dhe Kina, marrëdhënie e ngushtë në sfondin e Luftës së Ftohtë. Dokumente 1956-1978*. ASA, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2020.

⁹¹ *Rregullore e batalionit të këmbësorisë në luftim* (Tiranë: Shtëpia Botuese e Ushtrisë, 1976), 248.

Literaturë historiografike:

- Biberaj, Elez. *Albania and China. A Study of an Unequal Alliance*. Boulder and London: Westview Press, 1986.
- Boriçi, Gjon. *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1987*, bot. II. ASA, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2022.
- Boriçi, Gjon. "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë 1974-1975". Në *Studime historike*, nr. 1-2, 2018.
- Boriçi, Gjon. "Kreditë dhe ndihmat kineze për Shqipërinë". Në *Studime historike*, nr. 3-4, 2018.
- Boriçi, Gjon. "Përpjekjet e qeverisë shqiptare për të arritur industrializimin e vendit me anë të veprave të fundit madhore nga Kina në Shqipëri 1966 -1973". Në *Studime historike*, nr. 1-2, 2021.
- Bytyçi, Enver. *Shqipëri-Kinë, dështimi i një bashkëjetese*. Tiranë: Instituti i Studimeve të Europës Juglindore, 2014.
- Crump, Laurien. *The Warsaw Pact Reconsidered International Relations in Eastern Europe, 1955-1969*. New York: Routledge, 2015.
- Griffith, William E. *Albania and the Sino – Soviet Rift*. Cambridge: The M.I.T.Press, Massachusetts, 1963.
- Hamm, Harry. *Albania - China's beachhead in Europe*. New York, Frederick, A.Praeger, 1962.
- Kaba, Hamit. *Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë*. Tiranë: Botimpex, 2007.
- Kaba, Hamit. "Konflikti shqiptaro-sovjetik në optikën e fqinjëve të Shqipërisë". Në *Studime historike*, nr. 1-2, 2010.
- Lalaj, Ana. "Shqipëri në Paktin e Varshavës, 1955-1968". Në *Studime historike*, nr 1-2, 2004.
- Lüthi, Lorenz. *The Sino-Soviet Split. Cold War in the Communist World*. Princeton and Oxford: Princeton University Press, 2008.
- Mëhilli, Elidor. *From Stalin to Mao. Albania and the Socialist World*. Ithaca and London: Cornell University Press, 2017.
- Smaçi, Etleva. *Shqipëria në Traktatin e Varshavës*. (Disertacion për gradën "Doktor i shkencave"). Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2017.

Burime nga interneti:

- Biberaj, Elez. "Albanian-Chinese Relations 1962-1969", *Tirana Observatory: Foreign Policy and International Relations* 2, no. 3 (2020), 280-281 (shikuar më 21.06.2023).
<https://tiranaobservatory.com/2020/07/06/albanian-chinese-relations-1962-1969/>.

- Lüthi, Lorenz. "The People's Republic of China and the Warsaw Pact Organization, 1955-1963", *Cold War History* 7, no. 4 (2007).
https://www.researchgate.net/publication/240521710_The_People's_Republic_of_China_and_the_Warsaw_Pact_Organization_1955-63.
- Marku, Ylber. *Sino-Albanian relations during the Cold War, 1949-1978: an Albanian perspective*. Tezë doktrature. Hong Kong: Lingnan University, 2017. <https://scholars.ln.edu.hk/en/studentTheses/sino-albanian-relations-during-the-cold-war-1949-1978-an-albanian>.
- Marku, Ylber. "Communist relations in crisis: The end of Soviet-Albanian relations, and the Sino-Soviet split, 1960-1961". *The International History Review* 42, no. 4 (2020) (shikuar më 20.06.2023). DOI:10.1080/07075332.2019.1620825.
https://www.researchgate.net/publication/333513679_Communist_Relations_in_Crisis_The_End_of_Soviet-Albanian_Relations_and_the_Sino-Soviet_Split_1960-1961.
- Mëhilli, Elidor. "A Window into Mao's China, 1950-1970". In *A blog of the History and Public Policy Program* (Wilson Center, on December, 12, 2022), (shikuar më 20.06.2023).
<https://www.wilsoncenter.org/blog-post/window-maos-china-1959-1970>.
- Selvage, Douglas. "The Warsaw Pact and Nuclear Nonproliferation, 1963-1965". *Cold War International History Project* Vol. 32. Woodrow Wilson International Center of Scholars, 2001.
- Shen, Zihua. & Yafeng Xia. "Between Aid and Restriction: Changing Societ Policies towards China'Nuclear Weapons Program:1954-1960". *Nuclear Proliferation International History Project, Working Paper* 2. Wilson Center: May 2012.

ETLEVA SMAÇI

Academy of Armed Forces
etleva.smaci@aaf.mil.al; evasmaci@gmail.com

CHINESE MILITARY DIPLOMACY IN THE FRAMEWORK OF RELATIONS ALBANIA-
CHINA: A ASSAY FROM THE ALBANIAN ARCHIVES (1963-1975)

S u m m a r y

As has been demonstrated in this article, the political and ideological engagement, including the military cooperation between Albania and China,

was based on utilitarian motives on both sides. The analysis of military relations, the aid provided and the involvement strategy, focusing on defense and security, shows that the Chinese government used the Tirana regime in the clash with the Soviet Union, which was mostly related to its ideological and military interests, with a view to becoming a nuclear power.

On the other hand, the Albanian government factored this position by obtaining the largest amount of combat weapons received throughout the communist period. The militarization of the society, although undertaken due to the assistance offered by China, never convinced Beijing to join in the “psychosis” of the war that threatened Albania, according to the Albanian communist regime and the military circles that were in line with the then state politics.

Just as the alliance appears to have been politically and economically unequal, the same conclusion can be reached about military relations. While Tirana did not find it difficult to embrace Beijing's politics, seeking to secure a defense treaty, for Chinese diplomacy the red line was clear when it came to initiatives that could undermine its security policies. The principle of deterrence against the Albanian government, without using force as happened with Moscow, became the mainstay of military diplomacy.

The scheme applied in the military relations between Albania and China remains an open object of study, because while it served the conflicts within the bloc, it did not result in shifting the military balance of any of the countries, which was not to be perceived, to China's credit, as a threat either to the region or to the West.